



*Republika e Kosovës*  
*Republic of Kosova*



*Komuna Hani i Elezit*  
*Municipality of Hani Elezit*

## **DREJTORIA PËR ARSIM , KULTURË , RINI DHE SPORT**

Sektori i Arsimit e ushtron mbikëqyrjen profesionale pedagogjike mbi institucionet e edukimit parashkollor , fillor, arsimimit të mesëm të ulët dhe arsimimit të mesëm të lartë në Komunën e Hanit të Elezit, duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë si dhe në Statutin e Komunës. Komuna jonë ka tri SHFMU, pesë paralele të ndara të SHF dhe një SHM.

### **Objektivat e DKA-së**

- Përmirësimi i cilësisë në procesin edukativo-arsimor.
- Përcjellja permanente e punës në institucionet arsimore në komunë.
- Begatim i fondit të mjeteve mësimore, dhe përmirësimi i infrastrukturës në sektorin e arsimit.
- Planifikimi dhe menaxhimi efikas i buxhetit.
- Kordinimin e punëve me Kryetarin , KPF , KK dhe MASHT-in për mirvajtje të punëve në DKA.

### **Aktivitetet e DKA-së**

- ✓ Instalimi i nxehtës qendrore në sh.f.m.u. “K. e Diturisë”.(Komuna)
- ✓ Sigurimi i udhëtimit nxënësve që udhëtojnë më larg se 3 km. (Komuna)
- ✓ Rrethimi i pjesës së mbetur të oborrit të sh.f.m.u. “Ilaz Thaçi” .(DKA-ja )
- ✓ Ndërtimi i Palestresë sportive në oborrin e sh.f.m.u. “Ilaz Thaçi” .( donacion BE)
- ✓ Riparimi i dyshemesë së kl. në sh.f.m.u. “Ilaz Thaçi”. (DKA-ja)
- ✓ Riparimi i kulmit të sh.f.m.u. “I. Thaçi”. (donacion)
- ✓ Paisja me perde e sallave të shkollave për mësimdhënës. (donacion)

- ✓ Riparimi i dyerve të klasëve, dritareve dhe dyerve të korridorit si dhe toaleteve të sh.f.m.u. “V.Ballazhi” në Gorancë .(donacion)
- ✓ Lyerja e shkollës së Seqishtës, Krivenikut dhe Paldenicës (DKA-ja).
- ✓ Ndërtimi i dyerve të oborrit të shkollës së fshatit Laç. (DKA-ja)
- ✓ Vazhdimi i ndërtimit të fazës së dytë të sh.f.m.u. “Ilaz Thaçi” . (donacion)

## PLANI I PUNËS SË DREJTORISË SË ARSIMIT DHE KULTURËS SIPAS MUAJVE

Muaji	Aktiviteti	Vërejtje
Janar	Përgatitjet për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë. Përgatitja e Raportit të punës për Kuvend. Përgatitja e Planit të Punës. Vizitë shkollave.	
Shkurt	Përgatitja e Informatës për suksesin e arritur në gjysmëvjetorin e parë . Angazhim me drejtorët e shkollave për përgatitjet e manifestimit për Ditën e Pavarësisë.	
Mars	Vizitë shkollave për të parë mirëvajtjet e punëve në procesin edukativo-arsimor. Angazhim me drejtorin e sh.f.m.u. “I.Thaçi” për përgatitjet për Ditën e shkollës.	
Prill	Planifikimet për regjistrimin e nxënësve dhe pranimin e kuadrit në shkollën e mesme të lartë. Planifikimi i drejtimeve në shkollën e mesme të lartë në kuadër të drejtimeve të gjimnazit dhe i paraleleve në SHFMU-ta. Organizimin e garave dhe aktiviteteve të lira të nxënësve. Organizimin e maturës dhe semimaturës. Përgatitjet për Testin kombëtar dhe atij të maturës.	
Maj	Përgatitja e konkursit për kuadrin arsimor për vitin shkollor 2011/2012. Mbajtja e Kuizit të diturisë në mbikëqyrje të DKA-së në mes të shkollave të mesme të ultë. Vizitë shkollave për të parë rezultatet e punës së gjertanishme. Regjistrimi i nxënësve në mësimin parafillor dhe fillor.	
Qershor	Publikimi i konkursit për vitin shkollor 2011/2012. Përgatitjet për përfundim të vitit mësimor. Përgatitjet për pushimin vjetor të punëtorëve të arsimit.	

Korrik	Përgatitjet teknike (lyerje , riparim , rinovim dhe dezinfektim sipas nevojës) të objekteve shkollore për fillim të vitit të ri shkollor. Përgatitja e Informatës për përfundimin e vitit mësimor (gj. dytë) Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse për ngrohje. Vlerësimi i punës së organeve qeverisëse të shkollave (Këshilli i shkollës , Këshilli i Prindëve , Këshilli i arsimtarve , Aktivitet Profesional dhe Këshilli i nxënësve).	
Gusht	Hartimin dhe miratimin me kohë i programeve vjetore të shkollave. Vizitë shkollave për të parë përgatitjet tekniko – higjienike dhe kadrovike për fillimin e vitit të ri shkollor.	
Shtator	Përpjekjet për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në parashkollor . Përpjekjet për përfshirjen e të gjithë nxënësve në shkollim . Hartimi i informatës rreth përgatitjeve të institucioneve edukativo – arsimore për fillimin e vitit shkollor 2011 – 2012.	
Tetor	Raporti i suksesit të arritur në fund të vitit shkollor 2010/2011. Propozimi i masave për ngritje permanente të cilësisë dhe suksesit në mësim për vitin e ri shkollor.	
Nëntor	Vizitë shkollave për të përcjellë realizimin e planeve dhe programeve mësimore të SHFMU-ta dhe të mesme të lartë të komunës së Hanit të Elezi.	
Dhjetor	Përgatitjet për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë. Përgatitjet për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë.	

### Plani vjetor për Kulturë,Rini e Sport për vitin 2011

Muaji	Aktiviteti	Vërejtje
Janar		
Shkurt	* 17 shkurti - Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës- Organizohet program kulturalo-argëtues. * 26 shkurti- Dita e krismës së pushkëve çlirimtare – Ora e parë e mësimit në të gjitha shkollat i kushtohet veprës së lavdishme të UÇK-së	

Mars	<p>* 7 marsi – Dita e mësuesit</p> <p>* 8 marsi – Dita e gruasë</p> <p>Për nder të këtyre datave të hulumtohet mundësia e mbajtjes së një takimi të përbashkët për 7 dhe 8 marsin dhe ky takim të mbahet me 7 ose 8 mars.</p> <p>* Bashkëpunim me SHFMU-të “ Ilaz Thaçi “ për kremtimin e 29 marsit – ditës së shkollës</p>	
Prill	<p>*Takim me redaksitë e revistave “ Dardania “, “ E vërteta Sh “ dhe grupin letrar “ Kodi i Skenës “ për mirëvajtje të punëve.</p>	
Maj	<p>*Bashkëpunim me SHFMU-të “ Kështjella e Diturisë “ në Paldenicë me rastin e 4 majit – Ditës së shkollës</p> <p>*Bashkëpunim me shkollën e mesme të lartë “ Dardania “ në Han të Elezit për nder të 10 majit – Ditës së shkollës</p> <p>*31 Maji – Dita ndërkombëtare kundër duhanit – ligjerata në shkolla me temën: “ Sport e jo duhan “</p>	
Qershor	<p>* “Java Kulturore”:</p> <p>-1Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve organizohet një defile me fëmijët nëpër qytet dhe ipet një program nga fëmijët e të tri SHFMU-ta para shtëpisë së kulturës</p> <p>-Turnir në sporte të ndryshme</p> <p>-Krosi për nder të kësaj dite</p> <p>-11 qershor – Dita e Çlirimit - Koncert publik.</p>	
Korrik	<p>*Takim me bashkatdhetarët - Koncert publik.</p>	
Gusht	<p>*29 gushti – Dita e Dëshmorëve-Program kulturalo-artistik.</p>	
Shtator	<p>*21 Shtatori – Dita ndërkombëtare e paqës-gara në mes të shkollave të Komunës në vizatim me këtë temë.</p>	
Tetor		
Nëntor	<p>*Koncert për Ditën e Flamurit</p>	
Dhjetor	<p>*Bashkëpunim me shkollën fillore “ Veli Ballazhi “ në Gorancë me rastin e 14 dhjetorit – ditës së shkollës</p> <p>*Shpallja e sportistit, klubit dhe trajnerit më të mirë të vitit 2011</p>	